UDHËZIM
Nr. 10, datë 9.3.2015

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR MENAXHIMIN NËPËRMJET FONDIT KOMBËTAR TË BASHKËFINANCIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR PROJEKTET IPA

(ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 22.4.2016, nr. 26, datë 29.12.2016, nr. 1, datë 16.1.2018, nr. 22, datë 16.7.2019)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007, "Për ratifikimin e "Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të parazgjerimit (IPA)", VKM nr. 23, datë 12.1.2011, "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Europian, në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), komponenti I: Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional", *ligji nr. 37/2015, datë 9.4.2015, "Për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPA II)", vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 541, datë 18.6.2015, "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe struktu-rave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit IPA II (2014–2020)" dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 966, datë 2.12.2015, "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit të asitencës së paraanëtarësimit IPARD II (2014–2020), Sektori i Bujqësisë dhe i Zhvillimit Rural,* ministri i Financave

UDHËZON:

I. Strukturat e menaxhimit të decentralizuar:

Strukturat e menaxhimit të decentralizuar/ indirekt, në kuptimin e këtij udhëzimi, janë ato të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 12.1.2011, "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit të parazgjerimit (IPA), komponenti I: asistenca e tranzicionit dhe forcimi institucional", vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 541, datë 18.6.2015, "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit IPA II (2014–2020)" dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 966, datë 2.12.2015, "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit IPARD II (2014–2020), Sektori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

I.1 Detyrime financiare të përfituesit

Detyrime financiare të përfituesit, në kuptimin e këtij udhëzimi, janë të gjitha detyrimet financiare kontraktuale, fiskale apo të çdo natyre tjetër, kundrejt kontraktorit, institucioneve shtetërore apo Komisionit Evropian, të tilla si: bashkëfinancim, TVSH, penalitete apo korrektime financiare, të lindura në kuadër të zbatimit apo për shkak të një kontrate të menaxhuar në mënyrë të decentralizuar.

II. Procedurat për planifikimin (programimi)

II.1 Programet dhe projektet përkatëse që financohen nga fondet e BE-së, si edhe me bashkëfinancim nga buxheti i shtetit duhet të jenë pjesë e programit buxhetor afatmesëm, si edhe buxhetit vjetor të Njësive Shpenzuese të Qeverisjes së Përgjithshme (NJSHQP).

II.2 Gjatë procesit të hartimit të programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, midis Njësive Shpenzuese të Qeverisjes së Përgjithshme (NJSHQP) dhe Fondit Kombëtar duhet të bëhen rakordimet përkatëse, për përfshirjen në buxhet të programeve dhe projekteve përkatëse, të cilat janë me bashkëfinancim me fondet e BE-së.

Procedurat e detajuara të planifikimit të fondeve, si dhe afatet përkatëse janë të njëjta me ato të përcaktuara në udhëzimet për planifikimin e buxhetit afatmesëm, të buxhetit vjetor dhe të kalendarit vjetor të shpenzimeve.

II.3 CFCU-ja, si strukturë përgjegjëse për kontraktimin dhe tenderimin, përgatit dhe dorëzon pranë

Fondit Kombëtar një parashikim/plan të koordinuar të fondeve të BE-së (IPA), bazuar në llogaritjet e tyre dhe në fazën e gjendjes së implementimit të programit/projektit sipas planit përkatës të prokurimit, statusin e zbatimit të programit, si dhe detyrimet e pagesave që rrjedhin nga kontratat e nënshkruara me kontraktorët/përfituesit, duke respektuar rregullat PRAG të BE-së, sipas afateve të dorëzimit të kërkesave buxhetore afatmesme.

Fondi Kombëtar shqyrton dhe krahason të dhënat/shifrat nga kërkesat e NJSHQP-së, me parashikimin/planin e hartuar nga CFCU-ja, duke përgatitur një parashikim/plan të koordinuar të fondeve të BE-së (IPA) *ku pasqyrohen të gjitha detyrimet financiare të përfituesit sipas rastit.*

Parashikimi i koordinuar si më sipër i bëhet me dije të gjitha NJSHQP-ve, me qëllim negocimin e vlerave përfundimtare të bashkëfinancimit për projektet IPA. *Më pas, lista përfundimtare i dërgohet Drejtorisë përgjegjëse për Buxhetin dhe Investimet në Ministrinë e Financave.*

II.4. Agjencia IPARD si agjenci e pavarur, nën ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, si strukturë përgjegjëse për zbatimin e Programit IPARD II, përgatit dhe dorëzon pranë Fondit Kombëtar një parashikim/plan të fondeve IPARD II, bazuar në llogaritjet e tyre dhe fazën e implementimit të programit IPARD II për çdo masë, të kontratave të nënshkruara dhe në proces, si dhe të fazës së autorizimit dhe kontrollit të pagesave. Dorëzimi i planit bëhet duke respektuar afatet e dorëzimit të kërkesave buxhetore vjetore dhe afatmesëm.

Fondi Kombëtar shqyrton dhe krahason të dhënat/shifrat nga kërkesa e ministrisë përgjegjëse për Bujqësinë me parashikimin/planin e hartuar nga Agjencia IPARD, duke përgatitur një parashikim/plan të integruar të fondeve të IPARD II, i cili i dërgohet strukturës përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë e Financave.

III. Procedurat për zbatimin

III.1 Gjatë procesit të detajimit të fondeve buxhetore të miratuara në ligjin e buxhetit, nëpunësit autorizues të NJSHQP-ve janë përgjegjës për përfshirjen e fondeve të bashkëfinancimit dhe TVSH-së, *apo çdo detyrimi tjetër financiar*, të pagueshme nga buxheti i shtetit për projektet e financuara nga BE-ja dhe dërgimin e tyre për miratim në Ministrinë e Financave. Nëpunësit autorizues janë, gjithashtu, përgjegjës edhe për përfshirjen e këtyre fondeve në planin mujor të arkës.

Drejtoria e Fondit Kombëtar në ministrinë përgjegjëse për financat dhe investimet publike, brenda datës 5 janar të çdo viti buxhetor, dërgon pranë drejtorisë përgjegjëse për investimet publike në ministrinë përgjegjëse për financat, listën e plotë të NJSHQP-ve përfituese të projekteve të financuara me fonde IPA dhe kostove respektive të bashkëfinancimit dhe/ose TVSH-së, apo detyrime financiare të tjera, që duhet të mbulohen prej tyre për çdo projekt.

Në përllogaritjen e kostove të bashkëfinancimit dhe/ose TVSH-së, Fondi Kombëtar bazohet në parashikimet e bëra nga CFCU-ja, duke zbritur gjendjet e llogarive bankare në ditën e dorëzimit të listës pranë drejtorisë përgjegjëse për investimet publike në ministrinë përgjegjëse për financat.

Drejtoria përgjegjëse për investimet publike në ministrinë përgjegjëse për financat, gjatë shqyrtimit dhe miratimit të detajimit vjetor të listës së projekteve IPA të investimeve, merr në konsideratë edhe listën e detajuar të parashikimit të detyrimeve financiare të përfituesit dërguar nga Drejtoria e Fondit Kombëtar dhe mbikëqyr përfshirjen e tyre në listën përfundimtare të miratuar të projekteve për çdo ministri linje dhe institucion qendror.

Në rast rishikimi të buxhetit vjetor apo kërkese të NJSHQP-së për rialokim të fondeve të bashkëfinancimit dhe TVSH-së për projektet e financuara nga BE-ja, struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave dërgon për mendim te Fondi Kombëtar çdo rishikim apo rialokim që prek fondet e parashikuara për bashkëfinancimin dhe/ose TVSH-në e projekteve të bashkë-financuara/financuara nga BE-ja.

Fondi Kombëtar shqyrton dhe krahason të dhënat/shifrat e kërkesës për rishikim apo rialokim me parashikimin/planin e hartuar nga agjencitë implementuese (CFCU dhe/ose Agjencia IPARD) dhe brenda tre ditësh pune i kthen përgjigje Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit mbi pasojat e mundshme në implementimin e projektit /programit të IPA/IPARD II, të rishikimit /rialokimit të buxhetit sipas kërkesës së NJSHQP-së.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit nuk procedon me aprovimin e kërkesës së NJSHQP-së, në rast se nga Fondi Kombëtar i janë komunikuar pasoja të mundshme negative në implementimin e projektit/programit të IPA/IPARD II.

III.2 Detyrimet financiare të përfituesit të projektit/kontratës së financuar/bashkëfinancuar nga BE-ja, nga buxheti i shtetit (fondi i planifikuar në strukturën përkatëse të buxhetit vjetor në NJSHQP) transferohen nga llogaria e unifikuar e Thesarit "Depozitë e Qeverisë", në Bankën e Shqipërisë (TSA) në llogarinë bankare të dedikuar të Fondit Kombëtar, brenda 15 ditësh nga marrja e kërkesës së Fondit Kombëtar/ZKA-së drejtuar sekretarëve të përgjithshëm (zyrtarëve autorizues të NJSHQP-ve) për kalimin e shumës përkatëse të detyrimit financiar.

Sekretari i përgjithshëm/zyrtari autorizues i NJSHQP-së, brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e kërkesës së ZKA-së, e përdor atë si dokument justifikues dhe konfirmon urdhërshpenzimin, duke ia paraqitur atë degës së thesarit për transferimin e fondit nga TSA-ja në llogarinë e dedikuar të Fondit Kombëtar, sipas procedurës ekzistuese të kryerjes së transaksioneve të qeverisjes së përgjithshme nëpërmjet sistemit të thesarit.

Në rastet kur Fondi Kombëtar/ZKA-ja në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në ministrinë përgjegjëse për financat, vlerësojnë se shuma e bashkëfinancimit është e konsiderueshme (në raport me buxhetin e

NJSHQP-së dhe/ose madhësinë e projektit), kërkesa për kalimin e shumës përkatëse të bashkëfinancimit dhe TVSH-së (në rast se është e aplikueshme) nga TSA-ja në llogarinë e dedikuar të Fondit Kombëtar, bëhet me këste.

Transferta e bërë, bazuar në shkresën e ZKA-së konsiderohet si shpenzim në strukturën përkatëse buxhetore të institucionit buxhetor.

Përjashtimisht për vitin 2015, urdhri për transferimin e bashkëfinancimit do të bëhet menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

Fondi vjetor i bashkëfinancimit të palës shqiptare nga buxheti i shtetit për programit IPARD II, i planifikuar nga ministria përgjegjëse për bujqësinë nën kodin përkatës buxhetor të Agjencisë IPARD mbahet në llogarinë e unifikuar të thesarit "Depozitë e qeverisë" në Bankën e Shqipërisë (TSA) dhe kalohet në llogarinë e Fondit Kombëtar në bankën e nivelit të dytë, sipas procedurave të përcaktuar në manualet respektive të procedurave të Fondit Kombëtar dhe Agjencisë IPARD.

III.3 Brenda datës 20 janar të çdo viti Fondi Kombëtar kryen rakordimet e nevojshme me NJSHQP-të për shumat e shpenzuara në vitin paraardhës, duke përcjellë si dokumentacion justifikues të transferuesve kopje të faturave dhe/ose dokumenteve justifikuese të shpenzimit të paraqitur nga CFCU-ja, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

III.4 Shpenzimet që rrjedhin nga diferencat e kurseve të këmbimit dhe komisionet bankare të krijuara gjatë kryerjes së transaksioneve bankare në funksion të programeve/projekteve IPA (IPA I/IPA, II/IPARD II), mbulohet nga buxheti i Ministrisë së Financave (shpenzimet operative). Fondi Kombëtar, çdo vit, duke respektuar afatet e dorëzimit të kërkesave buxhetore vjetore dhe afatmesme, përgatit dhe dorëzon pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe/ose asaj të Financës, në Ministrinë e Financave, parashikimin për fondin e nevojshëm për mbulimin e shpenzimeve që parashikohet të krijohen nga diferencat e kurseve të këmbimit dhe komisionet bankare të transaksioneve bankare në funksion të programeve/projekteve IPA.

Brenda datës 20 janar të çdo viti Fondi Kombëtar kryen rakordimet e nevojshme me Drejtorinë e Financës në ministrinë përgjegjëse për financat për shumat e shpenzuara në vitin paraardhës, si dhe dorëzon kërkesën për fondin e nevojshëm për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara për vitin korrent. Fondi i kërkuar përllogaritet si diferencë mes shumës së shpenzimeve që parashikohet të krijohen nga diferencat e kurseve të këmbimit dhe/ose komisionet bankare, me gjendjet e llogarive bankare të Fondit Kombëtar (shumat e dedikuara për mbulimin e diferencave të kurseve të këmbimit dhe/ose komisionet bankare) në ditën e dorëzimit të kërkesës.

Fondi i parashikuar si më sipër transferohet nga ministria përgjegjëse për financat në llogaritë bankare të Fondit Kombëtar sipas kërkesave të Fondit Kombëtar/ ZKA-së.

Në rastet kur në përfundim të projektit/kontratës rezulton tepricë gjendje në llogarinë e Fondit Kombëtar të fondeve të transferuara nga përfituesi brenda të njëjtit vit buxhetor, brenda 30 ditëve nga përfundimi i projektit/kontratës Fondi Kombëtar merr masat për kryerjen e rakordimeve të nevojshme me përfituesin dhe kthimin e shumës së papërdorur në TSA. Në rast se tepricat janë fonde të mbartura nga vitet buxhetore paraardhëse, ato kthehen në Depozitën e Qeverisë me përshkrimin "Kthim fondesh të papërdorshme/kontrata XXX/përfitues YYYY".

IV. Procedurat e raportimit

Të dhënat e transaksioneve në pikën III.2 dhe/ose III.3, si më sipër, do të konsolidohen automatikisht nga SIFQ-ja në zërat ekzistues të raportit mujor dhe vjetor të treguesve fiskalë buxhetorë të konsoliduar, të dhënat e të cilit rakordohen, raportohen dhe publikohen periodikisht në zbatim të rregullores së brendshme.

Fondi Kombëtar, në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi dhe të udhëzimit të përvitshëm të ministrit të Financave për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin, brenda datës 5 të muajit pasardhës, dërgon raportimin për llogaritë speciale të fondeve të bashkëfinancimit dhe të fondeve të BE-së në Bankën e Shqipërisë, sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi si pjesë integrale e tij.

V. Procedura për financim të veçantë

Në rastet kur si pasojë e një vonese procedurale, apo për arsye të tjera objektive, gjendja e fondeve të BE-së në llogaritë e Fondit Kombëtar pranë Bankës së Shqipërisë rezulton e pamjaftueshme për të respektuar skedulin e paracaktuar të pagesave, Fondi Kombëtar merr masat e nevojshme për nisjen e procedurave për gjetjen e financimit të veçantë të nevojshëm (bridge financing).

Ministria përgjegjëse për financat merr masat për planifikimin e një fondi të dedikuar për mbulimin e financimit afatshkurtër. Fondi programohet nën programin "Ekzekutimi i pagesave të ndryshme", llogaria ekonomike 6040000, me emërtimin "Financim afatshkurtër për Fondin Kombëtar" .

Fondi Kombëtar, çdo vit, duke respektuar afatet e dorëzimit të kërkesave buxhetore vjetore dhe afatmesme, përgatit dhe dorëzon pranë drejtorisë përgjegjëse për financën, në ministrinë përgjegjëse për financat, parashikimin për fondin e nevojshëm për financimin e mundshëm afatshkurtër. Parashikimi bazohet në informacionin e disponueshëm nga Fondi Kombëtar duke marrë në konsideratë edhe vlerën e pagesave të parashikuara në vitin buxhetor për të cilin bëhet planifikimi, si dhe financimet afatshkurtra të ndodhura në tre vitet më të fundit buxhetore.

Fondi Kombëtar rakordon me drejtorinë përgjegjëse për financën, në ministrinë përgjegjëse, për financat para çdo procesi

planifikimi apo rishikimi të buxhetit, me qëllim planifikimin e një fondi sa më realist.

Në rastet kur fondi i buxhetuar si më sipër, nuk është i mjaftueshëm për mbuluar shumën e nevojshme për financim afatshkurtër, Fondi Kombëtar, bashkëpunon me drejtorinë përgjegjëse për buxhetin në ministrinë përgjegjëse për financat, për marrjen e masave për gjetjen e burimit të financimit brenda mundësive të buxhetit të shtetit të miratuar.

Fondi Kombëtar, me aprovimin e ZKA-së, i drejtohet zyrtarisht strukturës përgjegjëse për buxhetin e shtetit në Ministrinë e Financave për identifikimin e burimit të mundshëm për financim dhe ndjekjen e procedurave të nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Brenda 30 ditëve nga marrja e fondeve të vonuara/munguara nga BE-ja, Fondi Kombëtar merr të gjitha masat e nevojshme për kthimin në buxhetin e shtetit të fondeve të marra nga financimi afatshkurtër, së bashku me diferencat pozitive të krijuara nga kursi i këmbimit tyre, në rast se ka.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

MENISTRIA_____

RAPORTIM _ _____

PERIUDHA
_____

TE DALAT — Leke

ANALIZA	EMERTIMI	
	TOTALI TE DALA	**0.00**

TE HYRAT — Leke

ANALIZA	EMERTIMI	
	TOTALI TE HYRA	**0.00**

DIFERENCA

TE DALA MINUS TE HYRA =	
=NDRYSHIMI GJENDJES NE BND , SHTESE(-) PAKESIM(+)	0.00

INFORMATA MUJORE

PERIUDHA _____

GJENDJA MONETARE NE FILLIM TE PERIUDHES

VLERA MONETARE NE FILLIM TE PERIUDHES	
TOTALI	**0.00**

GJENDJA MONETARE NE FUND TE PERIUDHES

VLERA MONETARE NE FUND TE PERIUDHES	
TOTALI	**0.00**

NDRYSHIMI GJENDJES NE BND , SHTESE(-) PAKESIM (+)	0.00

DOKUMENTA NE UDHETIM

KONTROLLI _____